

U D H Ë Z I M
Nr.30, datë 5.5.2001

**PËR PARAQITJEN E DOKUMENTEVE DHE REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE PËR
DEPUTET PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT 2001**

Në mbështetje të neneve 45, 68 dhe 69 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, për paraqitjen e dokumentacionit, regjistrimin dhe shpalljen e kandidatëve që konkurojnë për deputetë të drejtpërdrejtë dhe deputetë të listave shumemërore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

U D H Ë Z O N:

1. Çdo person që kërkon të konkurojë për deputetë të drejtpërdrejtë në zonën një emërore, si dhe çdo subjekt tjetër zgjedhor (parti apo koalicion) i regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që paraqet listë shumemërore dhe që plotëson kushtet që përcakton neni 45, 68 dhe 69 i Kushtetutës dhe kërkesat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 22 ditë përpara datës së zgjedhjeve, ka të drejtë të paraqesë:

1.1 Në Komisionin e Zonës Zgjedhore ku dëshiron të kandidojë, për deputetë të drejtpërdrejtë:

- a) Dokument kandidimi për deputet në Kuvend, sipas modelit 6 (të miratuar nga KQZ-ja).
- b) Lista e 300 zgjedhësve që mbështesin kandidatin, sipas modelit 7.
- c) Deklaratë e subjektit zgjedhor (partisë ose koalicionit) që mbështet kandidatin, sipas modelit 8. Kjo deklaratë nuk është e nevojshme të dorëzohet nga kandidatët e pavarur.
- d) Në rastin e kandidatit të përbashkët subjektet që mbështesin kandidatin, në zbatim të nenit 66 pika “d”, duhet të deklarojnë me shkrim se cilës partie i llogaritet mandati i kandidatit nëse fiton, në rast të kundërt mandanti i tij shkon për llogari të partisë që ka fituar më shumë vota në shkallë vendi në raundin e parë.

1.2 Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për deputetë të listave shumemërore

Listën shumemërore për jo më pak se 20 kandidatë për deputetë, sipas modelit 6/2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Renditja e kandidatëve në listën shumemërore bëhet sipas vullnetit të subjektit zgjedhor (partisë ose koalicionit) që i paraqet. Pas miratimit dhe shpalljes së kësaj liste nga KQZ-ja, renditja e kandidatëve nuk ndryshohet.

Lista shumemërore shoqërohet edhe me:

- a) dokumentin e kandidimit për deputet të listës shumemërore në Kuvend, modeli 6/1, për çdo kandidat të përfshirë në listë;
- b) deklaratën e subjektit zgjedhor (partisë apo koalicionit) që mbështet kandidatin e listës shumemërore, sipas modelit 8/1.

1.3 Dokumentet e mësipërme, si rregull, paraqiten dorazi në komisionin respektiv dhe dorëzohen me procesverbal ku firmos kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i komisionit, sipas modelit 33 për KZZ-të dhe tek sekretari i KQZ-së, sipas modelit 9. Këto dokumente, menjëherë, bëhen hyrje në regjistrin e kandidatëve për deputet të KZZ-së apo KQZ-së.

2. KZZ-ja apo KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e dokumentacionit të paraqitur jo më vonë se 19 ditë para datës së zgjedhjeve.

2.1 Para marrjes së vendimit për regjistrimin e kandidatëve për deputetë të drejtpërdrejtë apo të listës shumemërore, KZZ-ja apo KQZ-ja verifikon plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 45, 68 të Kushtetutës dhe të kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe nëse vëren mospërputhje apo parregullsi në dokumentacion përpara mbarimit të afatit 19 ditë përpara datës së zgjedhjeve, i jep mundësi kandidatit apo subjektit zgjedhor përkatës që paraqet listë shumemërore për të korrigjuar mangësitë, me kusht riparaqitjen e dokumenteve, brenda afatit 19 ditë para datës së zgjedhjeve.

3. Kur vërtetohet se dokumentacioni i paraqitur nga kandidati apo subjekti zgjedhor është në rregull:

3.1 KZZ-ja në mbështetje të nenit 76 pika 1 të Kodit Zgjedhor merr vendim (sipas modelit 34):

- për regjistrimin e kandidatëve për deputetë të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore apo,
- në mbështetje të nenit 76, 77 dhe 78 të Kodit Zgjedhor për mospranimin e dokumenteve, duke përcaktuar edhe arsyen e mosregjistrimit të kandidatit.

3.2 KZZ-ja, mbështetur në vendimin e mësipërm bën menjëherë shpalljen e kandidatëve të regjistruar, pranë çdo qendre votimi, sipas modelit 35, i lëshon çdo kandidati vërtetimin model 36, për regjistrimin si kandidat për deputetë të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore përkatëse dhe u komunikon vendimin për mosregjistrimin e kandidatëve përkatës.

3.3 KQZ-ja, mbështetur në nenin 81, 82 dhe 83 të Kodit Zgjedhor, merr vendimin për regjistrimin e listës shumëmemërore të subjektit zgjedhor përkatës, sipas modelit 10, në të cilin shprehet edhe për kandidatët që nuk i regjistron duke përshkruar edhe arsyen e mosregjistrimit.

3.4 KQZ, mbështetur në vendimin e mësipërm dhe nenin 83 pika 2 të Kodit Zgjedhor, bën shpalljen e listës veças për çdo parti politike apo koalicion, sipas modelit 11, si dhe lëshon vërtetimin për regjistrimin e çdo kandidati të listës shumëmemërore, sipas modelit 12, duke i komunikuar zyrtarisht subjektit përkatës vendimin për kandidaturat që nuk është pranuar të bëhet regjistrimi.

Modelet e dokumenteve që përmenden, i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi